



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1385/24 Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Plotësohet/ndryshohet vendimi i KShC-së Ref.887/24 i datës 10.05.2024 ;
 - ii. Validohet riakreditimi ndërkombëtar i IAL-së IBCM për periudhën 1 tetor 2024 – 30 shtator 2025;
 - iii. Validohet riakreditimi ndërkombëtar i IAL-së IBCM për periudhën 1 tetor 2024 – 30 shtator 2025, për programet e studimit:
 1. *Menaxhimi i Mjedisit dhe Bujqësisë (Bachelor Profesional);*
 2. *Shitje dhe Marketing Ndërkombëtar (Bachelor Profesional); dhe*
 3. *Administratë Publike dhe Mirëqenie (Bachelor Profesional).*
- II. Validimi si në paragrafin I vlen sipas kriterëve dhe kuotave të përcaktuara me vendimin Ref.3037/21 të datës 12.08.2021 për validim të akreditimit ndërkombëtarë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

IBCM ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për validim të akreditimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të certifikatës së lëshuar nga Agjencia EVALAG, e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA).

Meqenëse IAL IBCM është në proces të transformimit/tranzicionit KShC në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas administrimit të provave dhe gjendjes së vërtetuar faktike dhe juridike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka njerërë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- IBC në Mitrovicë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Faqe 1 nga 1